



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr 185/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, për shkak të vendosjes së banerëve mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 10.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ashtu që Koalicionit LDK-AKR, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,300.00 (tremijë e treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 09.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 06.06.2017 diku rreth orës 13:10 aktivisti Veton Dragusha ka vërejtur se në magjistralen në dalje të Prizrenit është vendosur një baner i kandidatit të Koalicionit LDK-AKR Haxhi Avdyli. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4paragrafi 1 pika b) i Rregulles Zgjedhore 11/2013 dhe 3.4 të Rregulles Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së. Në mbështetje të pretendimeve në ankesë ka bashkangjitur fotografi të printuara nga vendi i ngjarjes në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë të datës 10.06.2017, koalicioni LDK-AKR, thekson se kane urdhëruar kandidatet që të ndermarin veprime permisuese me çka edhe është evituar shkelja. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografi me të cilat dëshmohet largimi i banerit nga vendi ku ka qenë i vendosur ai.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit për deputet nga Koalicioni LDK-AKR është i vendosur mbi rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LKP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që baneri i kandidatit për deputet nga koalicioni LDK-AKR, është i vendosur mbi rrugë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti baneri i kandidatit për deputet nga ky koalicion është i vendosur mbi rrugë publike ku koalicioni në fjalë ka bërë disa herë përsëritjen e të njëjtës shkelje në këto zgjedhje. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se Koalicionit në fjalë ia ka mundur për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërruar veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë larguar banerin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.185/2017 më datën 10.06.2017.



Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.